



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. : Prot.

Tiranë, më 1 .2021

VENDIM
Nr. 555, datë 01.12.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT
PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit , për vitin 2019”, i hartuar nga relatore znj. Brunilda Kadi,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.



PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

I

I

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1-A Njohuritë ligjore.

1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Nga vëzhgimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore, në 6 çështjet e përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtari ka njohje dhe zbatim korrekt të ligjit material penal dhe civil dhe dispozitave procedurale, të referuara në mbështetje të vendimeve të ndërmjetme, gjatë zhvillimit të seancave dhe në përfundim të tyre.

Nga vëzhgimi i 8 vendimeve burim vlerësimi, (6 dosjet e përzgjedhura me short dhe 2 të përzgjedhura nga vetë gjyqtari), konstatohet se gjyqtari, përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, duke i dhënë rëndësi identifikimit të shkakut ligjor të padisë, natyrën e mosmarrëveshjes me karakter civil, civil-familjar, si dhe natyrës së çështjes penale, konkretisht kërkesave për; *dërgim në gjyq të çështjes penale, pushimin e procedimit penal ato në fazën e ekzekutimit – përfitim ulje dënimi*. Përcaktimi i qartë i natyrës së çështjes nga gjyqtari shërben për organizimin e arsytimit ligjor të vendimit në drejtim të identifikimit dhe më tej argumentimit të çështjes/ve thelbësore të nevojshme për tu analizuar në raport me natyrën e çështjes.

Në lidhje me përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, gjyqtari kujdeset të evidentojë qartë ligjin, duke cituar të gjitha dispozitat e tij dhe /apo akteve nënligjore që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Në bazë të kategorisë së çështjes objekt gjykimi, gjyqtari përcakton në fillim të pjesës përshkuese arsytuese të vendimit, elemente që kanë të bëjnë me kompetencën (tokësore dhe lëndore), juridiksionin, trupin gjykues dhe procedurën e ndjekur nga gjykata. Më pas vijon me faktet e çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruara gjatë gjykimit. Pasi përshkruan faktet e çështjes, duke cituar provat përkatëse prej të cilave rezultojnë ato, gjyqtari përcakton ligjin e zbatueshëm, duke cituar ligjin procedural/material që zbatohet në çështjet objekt gjykimi. Gjyqtari paraqet dhe analizon rrethanat e faktit në mënyrë të qartë dhe mbi bazën e një renditje kronologjike. Përshkrimi i rrethanave të faktit, bëhet duke u ndërthurur me provat shkresore të marra gjatë gjykimit dhe veçimin e elementëve të faktit që rezultojnë të provuar prej tyre, duke e bërë të kuptueshëm rastin që është paraqitur për shqyrtim, ligjin e zbatueshëm dhe zgjidhjen që ka dhënë gjykata.

Paraqitja dhe analiza e fakteve të çështjes, duke iu referuar provave të administruara në gjykim, pa u lidhur me mënyrën se si palët i kanë parashtruar ato, i jep qartësi dhe kuptueshmëri faktit objekt gjykimi.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve të përzgjedhura për vlerësim.

Në tërësi, referuar të dhënave që evidentohen nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi secilin fakt, citimin dhe analizën e normave respektive, analizimin nga pikëpamja e ligjit dhe e provave të vendimit të dhënë nga Gjykata.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1-A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit konstatohet se gjyqtari, referon, citon dhe interpreton normat e ligjit procedural dhe material të zbatueshëm mbi faktet e çështjes, në shërbim të analizës ligjore dhe zbatimit të tyre në zgjidhjen e çështjes konkrete.

Gjyqtari në çdo vendim citon normat ligjore në një nënndarje të posaçme të pjesës arsyetuese të titulluar “Ligji i zbatueshëm”, duke i shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes konkrete. Në pjesën vijuese të arsyetimit, bëhet vlerësimi i gjykatës mbi bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kërkimeve objekt padie/kërkese apo objektit të çështjes penale.

Përveç citimit, në një pjesë të veçantë, në pjesën e vlerësimit të gjykatës, gjyqtari bën një analizë ligjore dhe interpretim të kuptimit të dispozitave të caktuara të ligjit procedural dhe material që gjejnë zbatim mbi rastin konkret. Ky interpretim, në disa raste bëhet në mënyrë të pavarur dhe në raste të tjera duke u ndërthurur drejtpërdrejtë me faktet e provuara në gjykim. Kjo e kushtëzuar edhe nga natyra e çështjeve të analizuara, të cilat në disa raste janë çështje jo komplekse, duke mos patur të nevojshëm interpretimin e zgjeruar të ligjit. Megjithatë, analiza ligjore përbën një rrjedhë logjike midis fakteve, interpretimit të ligjit, aplikimit të tij mbi faktin konkret dhe konkluzioneve të arritura nga gjyqtari.

Konkretisht, në 8 vendimet përfundimtare të vëzhguara, evidentohet se gjyqtari :

- citon/identifikon konkluzionet e arritura në vendimin unifikues nr.901/.2000 të Gjykatës së Lartë dhe njëkohësisht përcakton edhe kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për pranimin për shqyrtim të kundërpadisë së bashku me padinë objekt gjykimi;

-interpreteton në mënyrë teleologjike dhe literale, nenin 296 të K.Civil. Pas interpretimit teorik që i bëhet dispozitës relevante zbatuese në rastin konkret, i analizon këto kritere në përputhje me faktin juridik dhe provat e administruara në gjykim.

-interpreteton në mënyrë literale kushtet dhe kriteret për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, *neni 168 i K.Civil*. Pas interpretimit teorik që i bëhet dispozitës relevante zbatuese në rastin konkret, i analizon këto kritere në përputhje me faktin juridik dhe provat e administruara në gjykim për të;

-interpreteton normat e përgjithshme të K.Civil mbi interpretimin e kontratave në lidhje me akt marrëveshjen e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse;

-trajton në mënyrë abstrakte dhe teorike dispozitat materiale mbi përmbushjen e detyrimeve kontraktuale në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë të kontratës së sipërmarrjes, e vijon me zbatimin e saj me faktin dhe provat objekt gjykimi;

-interpreteton dispozitën materiale, nenin 132, 143, 6, 155, 158, 161, 192, 197 dhe 201/2 të K.Familjes;

-Interpreteton nenin 154/a të K.Pr.Civile në lidhje me efektet që ka paraqitja e padisë me të meta;

-interpreteton dispozitat procedurale penale të ndryshuara (*nenet 332 e vijues të K.Pr.Penale – mbi dërgim e çështjes në gjyq*) mbi qëllimin, funksionin dhe detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake në lidhje me konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale, papërdorshmërinë e provave apo mjaftueshmërisë së provave për të mbështetur akuzën dhe nëse hetimet e kryera nga ana e organit të akuzës janë të plota dhe të gjithanshme;

-analizon dhe interpreteton nën frymën e ligjit dispozitat e ndryshuara (*shtuara me ligjin 35/2017*) mbi gjyqtarin e seancës paraprake duke përcaktuar elementët e seancës paraprake në funksion të përcaktimit të funksionit dhe qëllimit të kësaj faze të re procedurale.

-interpreteton dispozitat procedurale penale të ndryshuara (*nenet 328, 329/a e vijues të K.Pr.Penale – mbi pushimin e akuzës apo të çështjes penale*) mbi qëllimin, funksionin dhe detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake në rastet kur organi i akuzës ka proceduar mbi pushimin e çështjes penale apo të akuzës konform nenit 328 të K.Pr.Penale;

-interpreteton nenin 66-1/ç , 186 të K.Penal, nenin 328 dhe 329/a të K.Pr.Penale;

-interpreteton *nenin 63 të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejta dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” i ndryshuar*, duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative në kërkesën e të dënuarit për të përfutur ulje dënimi.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante. Në disa nga vendimet e analizuara, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve dhe në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Konkretisht në 8 vendimet e vëzhguara gjyqtari citon, analizon dhe interpreteton: vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.901 datë 14.07.2000, nr. 5 datë 31.05.20211 , nr.3 datë 29.03.2012 si dhe vendimet nr. 87 datë 05.02.2013 dhe nr. 60 datë 07.02.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës. Në vendimet e vëzhguara, evidentohet se gjyqtari i kushton një rëndësi të veçantë citimit dhe zbatimit të parimeve të përgjithshme të së drejtës, e konkretisht; citon nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën e pronës si dhe *parimin procedural të një procesi të rregullt ligjor*, citon dhe zbaton parimin e interesit më të lartë moral dhe material

të fëmijëve të mitur; citon dhe zbaton *parimin i disponibilitetit në lidhje me padinë*, citon dhe zbaton parimet e së drejtës që kanë lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes, e konkretisht; citon *parimin e autonomisë kontraktuale, parimin e mirëbesimit, drejtësisë dhe ekuivalencës në lidhjen e kontratave*.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë për të interpretuar ligjin në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

I-B Arsyetimi ligjor

I-B-a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Vendimet gjyqësore të vëzhguara të gjyqtarit, janë të organizuara sipas një strukture të qartë dhe standardizuar, (pjesa hyrëse, arsyetuese, dispozitivi). Në pjesën hyrëse vendimet përmbajnë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, objektin dhe bazën ligjore, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve. Pjesa përshkruese arsyetuese, është e organizuar sipas një strukture të standardizuar me nënndarje, ku fillimisht analizohen rrethanat procedurale, më pas përshkruhen rrethanat e faktit, përcaktohet ligji i zbatueshëm dhe më pas vlerësimi i gjykatës nëpërmjet aplikimit të ligjit të zbatueshëm mbi faktet objekt gjykimi. Dispozitivi i vendimeve është i plotë i qartë dhe konkret. Në veprimet për drejtimin e seancave gjyqësore dhe vendimet përfundimtare, përdoret një gjuhë e thjeshtë, e qartë dhe e drejtpërdrejtë.

Gjyqtari përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, duke i bërë vendimet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte në aspektin gjuhësor. Fjalitë janë me gjatësi mesatare dhe ndërtohen në një mënyrë të tillë që të transmetojnë mendimin dhe të lidhen me njëra –tjetrën për nga vijimësia e kuptimit. Teksti i vendimeve është i organizuar në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë së mendimit.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht në ligjet e posaçme apo në aktet e ekspertimit. Ndërkohë, në shkrimin e vendimeve të vëzhguara, konstatohet edhe përdorimi i termave dhe shprehjeve në gjuhën latine, ndonjëherë të panevojshme dhe të pa shpjeguara në gjuhën shqipe.

Një karakteristikë në shkrimin e vendimeve përfundimtare të gjyqtarit është, jo vetëm citimi, por edhe vendosja e përmbajtjes së plotë të dispozitave procedurale apo materiale dhe më pas interpretimi dhe analiza në lidhje me zbatimin e tyre në rastin konkret. Gjithashtu, gjyqtari jo rrallë herë, citon dhe vendos të plotë përmbajtjen e dispozitave, që në rastet

konkrete kanë patur vetëm vlerë të përgjithshme dhe pa një lidhje të arsyeshme dhe të nevojshme me faktet e çështjes apo aspektet procedurale të gjykimit. Ky element vlerësohet se cenon konçizitetin e vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 12 pikë.

I-B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Gjyqtari i harton vendimet e tij me strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar. Vendimet e vëzhguara respektojnë me rigozitet strukturën formale me tre pjesë të vendimit, por edhe elementët e çdo pjese, siç përcakton neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe neni 383 i Kodit të Procedurës Penale. Çdo vendim gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Gjyqtari në hartimin e vendimeve ka një metodologji të qartë sipas pjesëve përbërëse të vendimit, me pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

Pjesa përshkuese arsyetuese është e ndarë në disa pjesë dhe gjithashtu të listuara formalisht si “Procedura dhe rrethanat e faktit”, “Legjislacioni i zbatueshëm” apo “Vlerësimi dhe analiza juridike”, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) Procedura dhe rrethanat e faktit në të cilën gjykata shkurtimisht ndalet në disa rrethana procedurale në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën, etj. Në vijim, gjyqtari e përshkruan faktin në fillim të pjesës përshkuese arsyetuese, fakt i integruar me provat objekt gjykimi. (ii) Legjislacionin e zbatueshëm në të cilën gjykata ndalet kryesisht në dispozitat relevante që do të shërbejnë zgjidhjes së çështjes civile apo penale. (iii) Vlerësimi i gjykatës në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet gjithashtu se dispozitivi i vendimit është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi padinë e evokuar nga paditësi, kërkimin e organit të akuzës për miratimin e pushimit të procedimit penal apo dërgimin e çështjes në gjyq, apo në lidhje me kërkesën penale të uljes së dënimit, por njëkohësisht edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi konstatohet e drejta e ankimit e cila fillon pas marrjes së dënimit në lidhje me arsyetimin e vendimit. Gjyqtari përdor teknikën e listimit të disponimeve duke i numërtuar ato, që lehtëson referencat në rastin kur vendimi ka disa disponime.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në: - nenin 310 të K.Pr.Civile në vendimet familjare dhe civile, - nenin 329 dhe 332/e të K.Pr.Penale në vendimet seancë paraprake (dërgim në gjyq apo pushimi i procedimit penal). Po kështu, vendimet përgjithësisht janë të strukturuar në paragrafë, me qëllim që palët të kuptojnë konkluzionin dhe arsyetimin e gjykatës për çdo pretendim të ngritur, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

Gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, identifikon faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, dhe konkluzionin e arritur.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

I-B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Në vendimet gjyqësore të vëzhguara, konstatohet se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të analizës dhe argumentimit logjik. Gjyqtari, identifikon dispozitat ligjore, shtjellon argumentat e gjykatës në mënyrë logjike, duke paraqitur një analizë të plotë të fakteve të çështjes, sëbashku me provat mbi të cilat ato mbështeten, si dhe paraqet argumentat në lidhje me bazueshmërinë ose jo të kërkimeve objekt gjykimi.

Në këto vendime, gjyqtari evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi duke orientuar dhe analizën e koncepteve dhe instituteve ligjore të tilla si; *paditë reale për mbrojtjen e pronësisë; ligjshmërinë ose jo të posedimit, konceptin e zhveshjes nga posedimi; institutin e parashkrimit fitues dhe elementët për fitimin e pronësisë; institutin e pronësisë; detyrimet, kontratën e sipërmarrjes; pasojat që rrjedhin nga mospërmbushja e detyrimeve kontraktuale; kushtin penal; plotësimin e detyrimeve ligjore nga ana e organit të akuzës për dërgimin e çështjes në gjyq, detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake, plotësimin e detyrimeve ligjore nga ana e organit të akuzës për pushimin e hetimeve, statusi i të dënuarit, institutin i uljes së dënimit të parashikuar në ligji i posaçëm, institutin e martesës dhe zgjidhjen e saj, pasojat ligjore të zgjidhjes së martesës mbi fëmijët e mitur, si dhe konceptet ligjore të këtyre kërkimeve si kërkime që nuk marrin formë të prerë në mënyrë substanciale por vetëm në mënyrë formale; kushtet që duhet të plotësoje paditësi në paraqitjen e kërkesë padisë dhe elementet e saj, si dhe në pasojën ligjore të mosplotësimit të tyre, etj.*

Në shumicën e vendimeve, gjyqtari analizon dhe lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkimet objekt padie ose pretendimet e palës së paditur, me faktin e provuar në gjykim si dhe me argumentin ligjor konkret, duke evidentuar lidhjen mes fakteve të provuara në gjykim me konkluzionin në lidhje me bazueshmërinë ose jo të pretendimeve nga pikëpamja ligjore. Analizon dhe individualizon përgjegjësinë penale të autorit të veprës penale, të drejtat e të pandehurit në procesin penal, rrethanat e faktit penal në përputhje me provat dhe parashikimet e ligjit material dhe procedural penal. Ai argumenton në mënyrë logjike përjasjen mes fakteve të provuara në gjykim, me ligjin e zbatueshëm, kuptimin e tij

nëpërmjet interpretimit dhe duke identifikuar lidhjen shkak-pasojë, mes faktit, ligjit dhe konkluzionit në zgjidhjen e çështjes.

Gjyqtari, evidenton në mënyrë të kuptueshme normën ligjore të zbatueshme, duke dhënë arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në çdo rast konkret. Dispozitat ligjore që gjejnë zbatim në çështjet konkrete, jo vetëm referohen/citohen, por dhe analizohen dhe interpretohen në raport me faktet e çështjes apo me kërkimet e palëve në gjykim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
97	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari ka gjykuar në total 144 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 46, ose 31.9% e tyre janë gjykuar jashtë këtij afati.

Për të vlerësuar këtë tregues, sipas metodologjisë së miratuar nga këshilli, këto të dhëna statistikore duhet të analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari në lidhje me këtë tregues shpjegon se: “Vlerësoj se kam patur efizienz shumë të lartë për këtë komponent, pavarësisht ngarkesës

shumë të lartë dhe mosndarjes së gjykatës në seksione. Nëse nuk janë respektuar afatet kjo ka ndodhur për shkak të kompleksitetit të çështjes, ngarkesës, modaliteteve, apo problemeve me njoftimet, sjelljes së palëve, apo arsye objektive të ndryshme mund të kenë çuar në zgjatjen e afatit. Nga analizimi i statistikave dhe verifikimit të secilës çështje, sqarohet se tejkalimi i afatit ligjor, kur ky ka qenë jo i arsyeshëm lidhet me:

A. Në lidhje me çështjet civile të përgjithshme me palë kundërshtare:

1. Çështja me nr. rendor 37, nr. 21239-00328-12-2019, dt. regj. 15.05.2019, afati i përfundimit të së cilës është 131 ditë. Kjo çështje i përket ankueses Entela Malajvs. përmbauesit gjyqësor privat Çezar Beja, me person të tretë Arjan Malaj, me objekt "Ankim kundër vendimit të përmbauesit për pushimin e ekzekutimit". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afatit ligjor 20 ditor lidhet me një sërë arsyesh si: probleme me njoftimet e palëve, kërkesën e ankueses për të gjetur avokat (ka patur dy avokate të ndryshëm), paraqitjen e dosjes përmbaimore nga përmbauesi, thirrjen prej gjykatës te personit të tretë Arjan Malaj, pyetjen e dëshmitarëve...etj. Përveç këtyre arsyeve, nga data 3-13 Qershor kam qenë me leje dhe deri në datën 21.06.2019 KLGJ ende nuk kishte marrë vendim për përsëritjen e transferimit të përkohshëm pranë Gj.Rr.Gj.Kavajë. Gjithashtu, ka përkuar edhe me pushimet e muajit Gusht. Në datën 23.09.2019 kam dhënë vendimin.
2. Çështja me nr. rendor 41, nr. 21255-00046-12-2019, dt. regj. 23.01.2019, afati i përfundimit të së cilës është 110 dite. Kjo çështje i përket paditëses Arjana Peza ; i paditur shërbimi përmbaimator Astrea ; person i trete Luan Cullhaj, Lulezim Cullhaj, Qemal Peza, me objekt « Kundërshtim veprimesh përmbaimore ». Sqarohet se çështja më është shortuar në datën 15.02.2019 dhe jo 23.01.2019, pasi gjyqtarja Entela Shedula ka dhënë dorëheqjen. Arsyeja e kohëzgjatjes tej afatit 20 ditor lidhet me një sërë arsyesh si: njoftimin e njëres prej palëve me shpallje dhe problemet e hasura; ndryshimit të avokatit prej « paditëses » ; vendosjen në dispozicion të praktikës përmbaimore nga përmbauesi dhe kompleksitetit të çështjes. Gjithashtu, ka përkuar edhe me lejen e kryer në fund të muajit Mars 2019.
3. Çështja me nr. rendor 42, nr. 21274-00018-12-2019, dt. regj. 16.01.2019, afati i përfundimit të së cilës është 64 ditë. Kjo çështje i përket ankuesit Bexhet Popavës shoqërisë përmbaimore "Enforcement Group" sh.p.k., Muharrem Dizdari, me objekt "Kundërshtim veprimesh përmbaimore". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afatit 20 ditor ligjor lidhet me një sërë arsyesh si: kryerjes së ekspertimit + ri-ekspertimit gjatë procesit dhe kërkesat e njëpasnjëshme për shtyrje të palës ankuese, duke u detyruar për të disponuar me pushimin e çështjes për këtë arsye.
4. Çështja me nr. rendor 45, nr. 21274-00895-12-2019, dt. regj. 05.11.2019, afati i përfundimit të së cilës është 49 dite. Kjo çështje i përket ankuesve shoqërisë "Diamma" sh.p.k., "Marion" sh.p.k. vs shoqërisë përmbaimore "Bailiff Officer" sh.p.k., Banka Credins sh.a., me objekt « Kundërshtim veprimesh përmbaimore ». Arsyeja e kohëzgjatjes tej afatit 20 ditor ligjor lidhet me marrjen fillimisht të masës së pezullimit, njoftimet e palëve dhe kompleksitetit të çështjes.
5. Çështja me nr. rendor 79, nr. 21274-00882-12-2018, dt. regj. 12.11.2018, afati i përfundimit të së cilës është 162 ditë. Kjo çështje i përket ankueses Oneda Shandrovës përmbaues gjyqësor privat Halit Cani; me objekt "Kundërshtim veprimesh përmbaimore.". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afatit ligjor 20 ditor lidhet me faktin se kam vendosur të parashtroj kompetencën në Gjykatën e Lartë, e cila është pranuar.

Pasi ka ardhur dosja është mbyllur administrativisht në sistem dhe është ridërguar në gjykatën kompetente atë të Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

B. Në lidhje me çështjet gjyqësore kërkesa penale të hetimit paraprak:

1. Çështja me nr. rendor 56, nr. 61002-01154-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 44 dite. Kjo çështje i përket kërkuarit Ervis Beu vs. Prokurorisë me objekt 'Heqje sekuestro të pasurisë'. Është shënuar gabimisht në tabelë si "Zëvendësim mase", e cila ka afat shqyrtimi 5 ditor.

C. Në lidhje me çështjet gjyqësore penale seancë paraprake:

1. Çështja me nr. rendor 1, nr. 61002-00311-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 90 ditë. Kjo çështje është shënuar gabimisht si çështje në seancë paraprake, pasi është themeli dhe është çështja penale në ngarkim të të pandehurve Ferdinand Saraçi, Shpendi Dema, Bujar Memolla, Indrit Dedej të akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të materialit zgjedhor dhe rezultatit të zgjedhjeve", parashikuar nga neni 326/2 i K.Penal. Çështja është gjykuar me procedure të zakonshme dhe procesi ka zgjatur tre muaj.

2. Çështja me nr. rendor 2, nr. 70101-00376-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 45 dite. Kjo çështje i përket ankuesit Mehmet Troka vs. Prokurorisë me objekt "Ankim kundër vendimit të mosfillimit". Çështja ka përfunduar tej afatit ligjor 30 ditor pasi ka patur probleme me njoftimet dhe njëkohësisht është kërkuar prej gjykatës një kopje e fashikullit të procedimit penal prej Prokurorisë, e cila nuk është sjellë në kohë.

3. Çështjet me nr. rendor 2, 3, 4, 5, 13 afati i përfundimit të të cilave është mbi 30 ditë. Kanë përfunduar tej afatit ligjor 30 ditor për shkak të kompleksitetit të çështjes, sjelljes së palëve dhe se është kërkuar prej gjykatës kopje e fashikullit të procedimit penal prej Prokurorisë, e cila nuk është sjellë në kohë.

4. Çështja me nr. rendor 37, nr. 71017-00317-12-2019, dt. regj. 21.02.2019 dhe dt. vendimi 09.04.2019, afati i përfundimit të së cilës është 47 ditë. Kjo çështje i përket kërkuarit Prokurorisë me objekt "Dërgim për gjykim të çështjes penale në ngarkim të te pandehurit Gazmend Maloku i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Vjedhjes", parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal. » Çështja ka zgjatur tej afatit ligjor 30 ditor, pasi ka patur 6 viktima, të cilët nuk kanë marrë dijëni dhe kam zhvilluar 4 seanca, konkretisht më datën 12.03.2019, 19.03.2019, 03.04.2019 dhe 09.04.2019. Sqaroh se nga data 22-30 Mars kam qene me leje.

5. Çështja me nr. rendor 38, nr. 71017-00339-12-2019, dt. regj. 01.03.2019 dhe dt. vendimi 17.04.2019, afati i përfundimit të së cilës është 47 ditë. Kjo çështje i përket kërkuarit Prokurorisë me objekt "Dërgim për gjykim të çështjes penale në ngarkim të te pandehurit Urim Karameta i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Mashtrimit", parashikuar nga neni 143/2 i K.Penal. » Çështja ka zgjatur tej afatit ligjor 30 ditor, pasi ka patur probleme me njoftimin e palëve; viktimës Besim Shuli, nuk i ish in garantuar të drejtat dhe kam zhvilluar 4 seanca, konkretisht më datën 18.03.2019, 03.04.2019, 08.04.2019 dhe 17.04.2019. Sqaroh se nga data 22-30 Mars kam qene me leje.

6. Çështja me nr. rendor 39, nr. 71017-00352-12-2019, dt. regj. 04.03.2019 (në tabela) dhe dt. vendimi 30.05.2019, afati i përfundimit të së cilës është 87 dite. Kjo çështje i përket kërkuarit Prokurorisë me objekt "Dërgim për gjykim të çështjes penale në ngarkim të te pandehurit Aleksander Elezi, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të

“Drejtimit te automjeteve ne mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal dhe “Moshindjes ndaj urdherit të punonjesit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242 i K.Penal.” Konstatohet se në tabele data e regj. është 04.03.2019 dhe është gabim pasi kjo çështje më është shortuar më datën 09.05.2019 dhe e kam përfunduar më datën 30.05.2019. Pra, është gjykuar brenda 21 ditëve.

7. Çështja me nr. rendor 40, nr. 71017-00389-12-2019, afati i përfundimit te se cilës është 179 dite. Kjo çështje i përket kërkuesit Prokurorisë me objekt “Dërgim për gjykim te çështjes penale ne ngarkim te te pandehurit Bislim Krasniqi, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Dhunës në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal. Çështja është regj. më datën 15.03.2019 dhe me vendimin e datës 15.04.2019 kam vendosur kthimin per hetime për një afat 3 (tre) mujor. Pas paraqitjes së dosjes e kam marrë në shqyrtim në datat 08.07.2019 dhe 18.07.2019, të cilat kanë dështuar për shkak se prokurori i çështjes ishte transferuar, si dhe seanca e datës 29.07.2019 është shtyrë për të kryer njoftimin me shpallje të viktimës, duke përfunduar çështjen më datën 10.09.2019. Duhet marrë në konsideratë edhe fakti se ka përkuar me pushimet e muajit Gusht.
8. Çështja me nr. rendor 41, nr. 71017-00450-12-2019, dt. regj. 28.03.2019 dhe dt. vendimi 08.11.2019, afati i përfundimit të së cilës është 225 dite. Kjo çështje i përket kërkuesit Prokurorisë me objekt “Dërgim për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurve Buz Hallulli dhe Razi Hallulli, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i K.Penal.” Çështja është regj. më datën 28.03.2019, janë zhvilluar tre seanca gjyqesore për njoftimin e të pandehurve më datat 17.04.2019, 06.05.2019 dhe 22.05.2019. Me datën 22.05.2019 kam vendosur pezullimin e çështjes për shkak se i pandehuri Razi Hallulli, nuk kishte dijeni për procesin penal në ngarkim të tij dhe e kam rivënë çështjen në lëvizje pas datës 23.09.2019, kur është paraqitur i pandehuri Razi Hallulli në gjykatë. Seanca e datës 09.10.2019 ka dështuar për shkak të mosparaqitjes së prokurorit. Seanca e datës 24.10.2019 ka dështuar për shkak të kërkesës për shtyrje të avokatit, duke e kam përfunduar më datën 08.11.2019.
9. Çështja me nr. rendor 43, nr. 71017-00487-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 204 ditë. Kjo çështje i përket kërkuesit Prokurorisë me objekt “Dërgim për gjykim te çështjes penale ne ngarkim te te pandehurit Shefqet Spanjolli, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186/1 i K.Penal. » Në tabelë çështja mban si datë regj. 08.04.2019, ndërkohë që më është shortuar më datën 03.10.2019 dhe e kam përfunduar më datën 29.10.2019, pra brenda 26 diteve.
10. Çështja me nr. rendor 44, nr. 71017-00544-12-2019, dt. regj. 18.04.2019 (është shënuar gabim ne tabelë 08.04.2019), afati i përfundimit te se cilës është 39 dite. Kjo çështje i përket kërkuesit Prokurorisë me objekt “Dërgim për gjykim te çështjes penale ne ngarkim te te pandehurit Aurel Xhani, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i K.Penal dhe “Largimi nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i K.Penal. » Çështja është marrë në shqyrtim në datën 14.05.2019 dhe 20.05.2019, por për arsye procedurale ka përfunduar në datën 27.05.2019.
11. Çështja me nr. rendor 47, nr. 71017-00626-12-2019, dt. regj. 09.05.2019, afati i përfundimit të së cilës është 54 ditë. Kjo çështje i përket kërkuesit Prokurorisë me

- objekt "Dërgim për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Brigel Zhuri, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Futjes, ose mbajtjes së sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimeve të vendimeve penale me burgim", parashikuar nga neni 324/a/1 i K.Penal. » Çështja është marrë në shqyrtim në datën 23.05.2019 dhe 29.05.2019, por për arsye procedurale është shtyrë për në datën 17.06.2019 (nga data 3-13 Qershor kam qenë me leje), seance e cila nuk u zhvillua për shkak se KLGJ, nuk kishte vendosur ende nëse do të vijojë me transferimin e përkohshëm pranë Gj.Rr.Gj.Kavajë, duke e përfunduar çështjen më datën 02.07.2019.
12. Çështja me nr. rendor 48, nr. 71017-00680-12-2019, dt. regj. 16.05.2019, afati i përfundimit të së cilës është 61 dite. Kjo çështje i përket kërkuesit Prokurorisë me objekt "Dërgim për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Bekim Ndreja, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Vjedhjes", parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal. Çështja është marrë fillimisht në shqyrtim në datën 28.05.2019, por për arsye procedurale është përfunduar në datën 16.07.2019. Sqarohet se nga data 3-13 Qershor kam qenë me leje dhe deri në datën 21.06.2019, nuk kam gjykuar pasi KLGJ, nuk kishte vendosur ende nëse do të vijojë me transferimin e përkohshëm pranë Gj.Rr.Gj.Kavajë. Seancat kanë dështuar për shkak të mosshoqërimit të të pandehurit nga toga e shoqërimit dhe njoftimit me shpallje të viktimës, duke e përfunduar çështjen më datën 16.07.2019.
13. Çështja me nr. rendor 51, nr. 71017-00884-12-2019, dt. regj. 04.07.2019, afati i përfundimit të së cilës është 77 ditë. Kjo çështje i përket kërkuesit Prokurorisë me objekt "Dërgim për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurve Genci Isha, Skerdi Koçi, Çim Proshka dhe Vilson Laci, akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Vjedhjes", më shumë se një herë kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 dhe 25 i K.Penal. » Çështja ka zgjatur tej afatit ligjor 30 ditor, pasi ka patur 22 viktima, të cilët nuk kanë marrë dijëni dhe janë njoftuar edhe me shpallje. Kam zhvilluar 4 seanca, konkretisht më datën 18.07.2019, 29.07.2019, 11.09.2019 dhe 19.09.2019. Ka përkuar edhe muaji Gusht që kam qenë me pushime, ndaj ka zgjatur gjykimi 77 ditë.
14. Çështja me nr. rendor 53, nr. 71017-00973-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 51 dite. Kjo çështje i përket kërkuesit Prokurorisë me objekt "Dërgim për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Blerind Kola i akuzuar për veprën penale të "Dhunës në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal. » Çështja është regjistruar më datën 29.07.2019 dhe muaji Gusht nuk duhet të përfshihet në afat. Praktikisht nuk kam patur mundësi ta përfundoj brenda 1 muaji, pavarësisht se e kam përfunduar me datën 26.09.2019, që i bie brenda 1 muaji pune.
15. Çështja me nr. rendor 54, nr. 71017-01028-12-2019, dt. regj. 09.09.2019, afati i përfundimit të së cilës është 44 dite. Kjo çështje i përket kërkuesit Prokurorisë me objekt "Dërgim për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Genci Manko i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Vjedhjes", parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal. » Çështja ka zgjatur tej afatit ligjor 30 ditor, pasi është njoftuar viktima me shpallje dhe kam zhvilluar 3 seanca, konkretisht me datën 23.09.2019, 08.10.2019 dhe 23.10.2019.
16. Çështja me nr. rendor 61, nr. 71017-01312-12-2019, dt. regj. 31.10.2019, afati i përfundimit të së cilës është 41 ditë. Kjo çështje i përket kërkuesit Prokurorisë me objekt "Dërgim për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Ervin

Vegshari i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikeve", parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal ». Çështja ka zgjatur tej afatit ligjor 30 ditor, pasi ka patur probleme me njoftimin/shoqërimin e të pandehurit në seance, mosparaqitjen e mbrojtësit të zgjedhur dhe kam zhvilluar 4 seanca gjyqësore, konkretisht më datën 21.11.2019, 26.11.2019, 03.12.2019 dhe 11.12.2019.

17. Çështja me nr. rendor 65, nr. 71017-01345-12-2019, dt. regj. 07.11.2019, afati i përfundimit të së cilës është 46 ditë. Kjo çështje i përket kërkuesit Prokurorisë me objekt "Dërgim për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Arif Lita i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Vjedhjes", parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal ». Çështja ka zgjatur tej afatit ligjor 30 ditor, pasi ka patur probleme procedurale me njoftimin e 4 viktimave dhe shoqërimin e të pandehurit në seancë. Kam zhvilluar 3 seanca me datën 02.12.2019, 13.12.2019 dhe 23.12.2019.

18. Çështja me nr. rendor 66, nr. 71017-01345-12-2019, dt. regj. 14.11.2019, afati i përfundimit të së cilës është 39 ditë. Kjo çështje i përket kërkuesit Prokurorisë me objekt "Dërgim për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurës Resmije Krasniqi e akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Vjedhjes së energjisë elektrike, ose impulseve telefonike", të parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal. Çështja ka zgjatur tej afatit ligjor 30 ditor, pasi ka patur probleme procedurale me njoftimin e viktimës dhe kam zhvilluar 2 seanca, konkretisht më datën 13.12.2019 dhe 23.12.2019.

Vlerësoj se faktet e mësipërme duhet të merren në konsideratë, pasi lidhen me arsye ligjore dhe objektive, të cilat kanë ndikuar në mos respektimin e afatit ligjor dhe janë lehtësisht të vërtetueshme, duke verifikuar secilën prej dosjeve."

Në analizë të këtyre shpjegimeve rezulton se; numri i çështjeve për të cilat gjyqtari ka dhënë shpjegime të arsyeshme dhe të pranueshme është 26. Ndërkohë, duke zbritur nga numri total 46, këto 26 çështje të gjykuara, numri i tyre shkon në 20 ose 13.8% .

Gjithashtu, duhet marrë parasysh edhe;

a) përjashtimin nga kjo periudhë, kohën që mund të ketë marrë lëvizja e dosjes nga momenti i regjistrimit deri te shortimi dhe dorëzimi te gjyqtari,

b) kohën që i është dashur gjyqtarit për shtyrje të gjykimit për shkaqe të pavarura prej tij, si është njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve,

c) si dhe faktit se në disa raste, sipas të dhënave statistikore, konstatohet se tejkalimi i afatit ligjor është për një kohë relativisht të shkurtër dhe që nuk i përkasin atyre çështjeve për të cilat gjyqtari ka dhënë shpjegime (tabela 1, nr. rendor 46 dhe 47), në lidhje me këtë tregues, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal, duke u pikëzuar më 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari ka gjykuar në total 486 çështje, për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal. Nga këto, 125 ose 25.7 % të tyre, janë gjykuar jashtë këtyre afateve.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari në lidhje me këtë tregues shpjegon se:
Vlen i njëjti shpjegim si më sipër. Nga analizimi i statistikave dhe verifikimit të secilës çështje, sqarohet se tejkalimi i afatit ligjor, kur ky ka qënë jo i arsyeshëm lidhet me:

A. Në lidhje me çështjet civile të përgjithshme me palë kundërshtare:

1. Çështja me nr. rendor 51, nr. 11232-00525-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 378 dite. Kjo çështje i përket paditësit shërbimit përmbarimor FS sh.p.k., me te paditur Qani Lika, Haklime Lika, Irma Çaçë, Selman Lika, Mimoza Lika, Malvina Abdishahi, Rovena Dakavelli, Rozeta Lika, me objekt "Veçim pjese takuese të debitorit b/pronar". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore lidhet me njoftimet e palëve te paditura, te cilët janë njoftuar me shpallje dhe disa here nuk konfirmohet marrja dijeni prej tyre, duke ndikuar mbi afatin 30 ditor të paraqitjes së deklaratës së mbrojtjes.
2. Çështja me nr. rendor 52, nr. 11232-00641-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 291 dite. Kjo çështje i përket paditësit shërbimit përmbarimor FS sh.p.k., me te paditur Mersin Doja, Besnik Doja, Bashkim Doja, Zak Doja, Ramazan Doja, Skender Doja, Vjollca Kurti, me objekt "Veçim pjese takuese të debitorit b/pronar". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore lidhet me njoftimet e palëve te paditura, te cilët janë njoftuar me shpallje dhe disa here nuk konfirmohet marrja dijeni prej tyre, duke ndikuar mbi afatin 30 ditor të paraqitjes së deklaratës së mbrojtjes.
3. Çështja me nr. rendor 53, nr. 11232-00659-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 361 ditë. Kjo çështje i përket paditëses Suzana Gjata, me te paditur Ibrahim Gjeci, me person të trete Nj.A.Synej, me objekt "Mbrojtje servituti...etj." Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak se me datën 22.12.2018 kam vendosur pezullimin e gjykimit pas konstatimit të faktit se pala e paditur kishte ndërruar jete. Duke qene se kaluan mbi 10 muaj dhe nuk u thirren prej paditëses, apo nuk u paraqiten trashëgimtarët e të ndjerit, kam proceduar kryesisht me pushimin e çështjes.
4. Çështja me nr. rendor 55, nr. 11232-00706-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 401 dite. Kjo çështje i përket paditësve Isa Tatani, Fatime Tatani; me pale të paditura: Arben Sara, Banka e Tiranës, përmbarues gjyqësor privat Alsi Kamberi, ASHK Kavajë; me objekt: "Konstatim paligjshmëri veprimesh përmbarimore, detyrim njohje pronar, përjashtim sekuestro, detyrim regjistrim pasurie dhe marrje mase sigurim padie". Arsyeja kryesore e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak te problemeve me njoftimin e palës se paditur Arben Sara, i cili është njoftuar me shpallje, si dhe mundësimin e përpjekjeve të palëve paditëse me palën e paditur Tirana Bank sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim, e cila u finalizuar midis tyre.
5. Çështja me nr. rendor 60, nr. 11236-00546-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 315 ditë. Kjo çështje i përket paditësit Agron Hodo, pale e paditur Sherife Dervishi, me objekt "Shpërblim dëmi". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore është kryerja e ekspertimit + aktit shtese, pyetja e dëshmitarëve, problemet me njoftimet dhe kërkesat për shtyrje nga pala e paditur.
6. Çështja me nr. rendor 76, nr. 21240-00235-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 484 dite. Kjo çështje i përket paditësit Intersig Vienna Insurance Group sh.a.,

pale e paditur Shyqyri Haka, me objekt: "Kthim shume". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore lidhet me faktin se data e regjistrimit fillestar te çështjes është 04.03.2018, kur unë nuk kam qenë gjyqtar i Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Kavaje. Çështja më është më datën 11.12.2018. Pra, kohëzgjatja e gjykimit është 230 ditë, 7 muaj e 20 dite. Kjo ka ndodhur për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe arsyeve objektive procedurale.

7. Çështja me nr. rendor 77, nr. 21253-00707-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 385 dite. Kjo çështje i përket paditësit Frederik Tengu, Edmond Tengu, Marjana Ligeja, Florina Andoni, Vasil Tengu, me te paditur Mihal Mihani, Rustem Bici, me person të tretë ASHK Kavaje, me objekt "Pavlefshmëri kontrate dhurimi...etj.". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore lidhet sjelljen e palëve, kompleksitetin e çështjes dhe lënien kohe për ta zgjidhur mosmarrëveshjen me pajtim, pasi ishin te afërm.
8. Çështja me nr. rendor 84, nr. 23000-00860-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 239 dite. Kjo çështje i përket paditëses Elona Kalanxhi; i paditur Petrit Bajrami; me objekt "Lejim kalim kufiri të fëmijës se mitur". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak të problemeve me njoftimin e palës se paditur me shpallje.

B. Në lidhje me çështjet gjyqësore civile pa palë kundërshtare:

1. Çështja me nr. rendor 28, nr. 90108-00048-12-2019, dt. regj. 28.01.2019, afati i përfundimit të së cilës është 158 ditë. Kjo çështje është shënuar gabimisht si çështje civile pa pale kundërshtare pasi i përket paditësit Bilal Bulku, me te paditur OSHEE sh.a. me objekt "Dëmshpërblim që buron nga marrëdhënia e punës". Pra, është çështje themeli civile dhe është zgjidhur brenda afatit minimal 6 mujor.
2. Çështja me nr. rendor 32, nr. 90108-00510-12-2019, dt. regj. 08.07.2019, afati i përfundimit të së cilës është 100 ditë. Kjo çështje i përket kërkueses Rajmonda Berberi me objekt "Ndreqje gabimi". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afatit minimal 2 mujor lidhet me faktin se personi i tretë Bujar Berberi është njoftuar me shpallje, si dhe për shkak të pushimeve të muajit Gusht. Çështja ka përfunduar më datën 16.10.2019.

C. Në lidhje me çështjet gjyqësore familjare me palë kundërshtare:

1. Çështja me nr. rendor 2, nr. 21001-00013-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 278 ditë. Kjo çështje i përket paditësit Oltian Uku, e paditur Olsiana Uku, me objekt "Zgjidhje martese dhe lënien e fëmijëve te mitur...etj.". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak te problemeve me njoftimin e palës se paditur me shpallje, respektimit të afatit te deklaratës se mbrojtjes, procedurës së pajtimit dhe kryerjes së aktit të ekspertimit.
2. Çështja me nr. rendor 3, nr. 21001-00019-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 187 ditë. Kjo çështje i përket paditëses Luiza Xhani, i paditur Gentin Xhani, me objekt "Zgjidhje martese.". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak te problemeve me njoftimin e palës se paditur me shpallje, respektimit të afatit te deklaratës se mbrojtjes, procedurës së pajtimit dhe kryerjes së aktit të ekspertimit.
3. Çështja me nr. rendor 5, nr. 21001-00060-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 279 ditë. Kjo çështje i përket paditësit Selvina Vrapi, i paditur Gentian Vrapi, me objekt "Zgjidhje martese.". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka

ardhur për shkak të problemeve me njoftimin e palës së paditur me shpallje dhe respektimit të afatit të deklaratës së mbrojtjes.

4. Çështja me nr. rendor 10, nr. 21001-00186-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 221 ditë. Kjo çështje i përket paditësit Maliq Lusha, e paditur Selvie Lusha, me objekt "Zgjidhje martese dhe lënien e fëmijëve të mitur...etj.". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak të kompleksitetit të çështjes, procedurës së kryerjes së aktit të ekspertimit dhe marrjen e mendimit fëmijëve të mitur në seance se me cilin prind dëshironin të qëndronin.
5. Çështja me nr. rendor 39, nr. 21001-00635-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 240 ditë. Kjo çështje i përket paditëses Rajmonda Berberi, i paditur Bujar Berberi, me objekt "Zgjidhje martese dhe lënien e fëmijëve të mitur...etj.". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak të problemeve me njoftimin e palës së paditur me shpallje, respektimit të afatit të deklaratës së mbrojtjes, procedurës së pajtimit dhe kryerjes së aktit të ekspertimit.
6. Çështja me nr. rendor 43, nr. 21001-00688-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 240 ditë. Kjo çështje i përket paditësit Deshir Elezi, e paditur Eniza Beqja, me objekt "Zgjidhje martese dhe lënien e fëmijëve të mitur...etj.". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak të problemeve me njoftimin e palës së paditur me shpallje, respektimit të afatit të deklaratës së mbrojtjes, procedurës së pajtimit dhe kryerjes së aktit të ekspertimit.
7. Çështja me nr. rendor 44, nr. 21001-00696-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 240 ditë. Kjo çështje i përket paditëses Arta Gjoci, i paditur Ervis Gjoci, me objekt "Zgjidhje martese". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak të problemeve me njoftimin dhe kompleksitetit të çështjes. Kam hetuar në lidhje me vlefshmërinë e martesës dhe kam disponuar në përfundim me pavlefshmërinë e saj.
8. Çështja me nr. rendor 46, nr. 21001-00729-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 240 ditë. Kjo çështje i përket paditësit Ilirjan Hazisllari, e paditur Laureta Hazisllari, me objekt "Zgjidhje martese dhe lënien e fëmijëve të mitur...etj.". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak të problemeve me njoftimin e palës së paditur me shpallje dhe respektimit të afatit të deklaratës së mbrojtjes, si dhe procedurës së kryerjes së kryerjes së aktit të ekspertimit, e cila ka rezultuar e pasuksesshme për faj të palës paditëse dhe çështja është pushuar.
9. Çështja me nr. rendor 50, nr. 21001-00798-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 12 muaj. Afati i përfundimit të çështjes është i gabuar pasi data e regj. është 11.01.2018 dhe vendimi është dhënë më datën 07.01.2019. Pra, është zgjidhur në më pak se dy muaj.
10. Çështja me nr. rendor 51, nr. 21001-000813-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 14 muaj. Afati i përfundimit të çështjes është i gabuar pasi data e regj. është 08.11.2018 dhe jo 11.08.2018, si dhe vendimi është dhënë më datën 10.07.2019 dhe jo 07.10.2019. Pra, çështja është zgjidhur brenda 8 muajve, ose 242 ditëve.
11. Çështja me nr. rendor 57, nr. 21001-00668-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 300 ditë. Kjo çështje i përket paditësit Gjovalin Kola, e paditur Vasilika Lika, Gjergji Gjoka dhe personi i trete Z.Gj.Civile e Nj.A.Golem, me objekt "Njohje atësie". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak të kompleksitetit të çështjes. Ndodhësja përpara një rasti që fëmija ishte 15 vjeç dhe i

paregjistruar ne gjendjen civile, pra nuk ekzistonte si shtetas. Babai refuzonte regjistrimin pasi nuk donte të dilte me atësi te dikujt tjetër (prezumuar) dhe jam përpjekur jashtë mase qe fëmija te regjistrohej fillimisht dhe pastaj të vijoja gjykimin e çështjes. Kam kryer ekspertim psikologjik dhe njëkohësisht kam pyetur dëshmitarë, të cilat kanë marrë kohë.

12. Çështja me nr. rendor 58, nr. 21013-00666-12-2018, dt. regj. 20.09.2018, afati i përfundimit të së cilës është 13 muaj. Kjo çështje i përket paditëses Urime Hysenaj, i paditur Bardhyl Hysenaj, me objekt "Heqje përgjegjësie prindërore". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak të njoftimeve të palës së paditur me shpallje; kompleksitetit të çështjes; kryerjes se ekspertimit; pyetjes se dëshmitareve dhe kryerjen e një hetimi të plote të çështjes.

D. Në lidhje me çështjet gjyqësore familjare pa palë kundërshtare:

1. Çështja me nr. rendor 4, nr. 21012-00885-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 97 ditë. Kjo çështje i përket kërkuës Çausht Aga, Irena Aga, me objekt "Lëshim autorizimi për fëmijën e mitur dhe personin e pazotë". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe hetimit prej meje, pasi kërkohej lëshim autorizimi edhe për fëmijët e mitur, por edhe për një person të pazotë në kujdestari të kërkueses Irena Aga. Pra, ishin dy kërkesa në një dhe është kryer hetim.

E. Në lidhje me çështjet gjyqësore marrëdhënie pune:

1. Çështja me nr. rendor 1, nr. 21285-00238-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 252 dite. Kjo çështje i përket paditësit Entit te Banesave Durrës, te paditur: Ahmet Galicaj, Fatime Galicaj, Ervin Galicaj, Erida Shabani, Diana Galicaj; me objekt: "Zgjidhje kontrate". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak të problemeve me njoftimet dhe lënien kohë palëve për ta zgjidhur mosmarrëveshjen me pajtim.

2. Çështja me nr. rendor 3, nr. 11232-00697-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 200 ditë. Kjo çështje i përket paditësit Shpend Haxhihyseni, të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP Rrogozhinë, me objekt "Zgjidhje marrëdhënie pune". Arsyeja e kohëzgjatjes tej afateve minimale kohore ka ardhur për shkak se fillimisht ishte thirrur ne cilësinë e palës se paditur IEVP Rrogozhine dhe me pas u kërkuar zgjerimi i ndërgjyqësisë edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, duke u lënë dy herë afat për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes.

F. Në lidhje me çështjet gjyqësore penale krime:

1. Çështja me nr. rendor 25, nr. 58345-01156-12-2018, afati i përfundimit të së cilës është 250 dite. Kjo çështje i përket të pandehurit Gjyrkan Kuqi, i akuzuar për kryerjen e veprës penale te "Drejtimin te automjetit ne mënyrë te parregullt" dhe "Falsifikimit te dokumentave", parashikuar nga nenet 291 dhe 186/1 te K.Penal. Me rezulton se data e regjistrimit ne tabelë 11.05.2018 është e gabuar, pasi kam filluar si gjyqtar ne Kavaje ne Qershor. Data e sakte është 05.11.2018 dhe ka përfunduar me datën 22.01.2019, pra brenda 76 ditëve.

G. Në lidhje me çështjet gjyqësore penale kundërvajtje:

-Çështja me nr. rendor 1, nr. 52307-01049-12-2018, afati i përfundimit te se cilës është 130 dite. Kjo çështje i përket viktimës akuzuese Guxim Manga me te akuzuar Filat Aliaj, për kryerjen e veprës penale "Dëmtime të tjera me dashje", parashikuar

nga neni 90 i K.Penal. Çështja është gjykuar me procedure te zakonshme dhe janë pyetur dëshmitarë/dëshmitarë të mitur dhe eksperti mjeko-ligjor.

H. Në lidhje me çështjet gjyqësore penale seancë paraprake:

1. Çështja me nr. rendor 15, nr. 71003-00154-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 157 dite. Kjo çështje i përket kërkuarit Prokurorisë me objekt "Bashkim dënimesh për të dënuarin Klajdi Kurti". Konstatohet se në tabelë është hedhur gabim data e regjistrimit 28.01.2019, ndërkohë që është 28.04.2019 dhe ka përfunduar në datën 04.07.2019, pra 66 ditë.
2. Çështja me nr. rendor 19, nr. 70103-00893-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 84 ditë. Kjo çështje i përket kërkuarit Prokurorisë me objekt "Bashkim dënimesh për të dënuarin Jurgen Cenaj". Vërtet çështja është gjykuar për 84 ditë, por është regjistruar në datën 08.07.2019 dhe ka përfunduar në datën 30.09.2019. Faktikisht afati i gjykimit është 1 muaj e 23 ditë, pasi ka përkuar me muajin Gusht.
3. Çështja me nr. rendor 29, nr. 71016-00180-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 84 ditë. Kjo çështje i përket kërkuarit Elis Dakavs Prokurorisë me objekt "Zëvendësim mase mjekësore "Mjekim i detyruar spitalor" në "Mjekim i detyruar ambulator". Çështja ka zgjatur për shkak të kryerjes së ekspertimit prej ekspertëve të IML-se.
4. Çështja me nr. rendor 30, nr. 71016-00686-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 148 ditë. Kjo çështje është me objekt "Rivlerësim i masës mjekësore për shtetasin Mustafa Kola". Çështja ka zgjatur për shkak të kryerjes së ekspertimit prej ekspertëve të IML-se.
5. Çështja me nr. rendor 102, nr. 71018-00225-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 81 ditë. Kjo çështje i përket kërkuarit Prokurorisë me objekt "Pushim e procedimit ndaj shtetasit nën hetim Fatmir Krasniqi, i hetuar për veprën penale të "Shkeljes se rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290/1 i K.Penal. Çështja ka zgjatur për shkak të kërkesave të palëve dhe kompleksitetit të çështjes. Gjithashtu, ka përkuar me pushimet e muajit Mars 2019.
6. Çështjet me nr. rendor 137 dhe 138, me objekt "Pushim procedimi penal", afati i përfundimit të të cilave është respektivisht 62 dhe 76 ditë. Sqarohet se prej datës 03.06.2019 deri në datën 13.06.2019 kam qënë me lejë dhe nga data 13.06.2019-21.06.2019 KLGJ ende nuk kishte vendosur në lidhje me përsëritjen e transferimit të përkohshëm. Pra, për rreth 18 ditë nuk kam gjykuar për arsye objektive, të cilat nëse zbriten nga afati i gjykimit do të konsideroheshin brenda afatit.
7. Çështja me nr. rendor 140, nr. 71018-00646-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 154 ditë. Kjo çështje i përket kërkuarit Prokurorisë me objekt "Pushim e procedimit ndaj shtetasit nën hetim Ilvi Meta, i hetuar për veprën penale të "Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armeve shpërthyese dhe municionit", parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal. Çështja ka zgjatur për shkak të ndryshimit të prokurorit të çështjes për shkak transferimi, pra mungesës së palëve dhe pushimeve të muajit Gusht.
8. Çështja me nr. rendor 142, nr. 71018-00788-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 90 ditë. Kjo çështje i përket kërkuarit Prokurorisë me objekt "Pushim e procedimit ndaj shtetasit nën hetim Florian Puqaja, i hetuar për veprën penale të "Prodhimit dhe shitjes se narkotikeve", parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.

Çështja është regjistruar me datën 13.06.2019 dhe ka përfunduar me datën 11.09.2019. Ka zgjatur për shkak të disponimit të plotësimit hetimesh dhe pushimeve të muajit Gusht.

9. Çështja me nr. rendor 158, nr. 71019-00155-12-2019, afati i përfundimit të së cilës është 79 ditë. Kjo çështje i përket kërkuarit Luan Balliu me objekt « Rishikim vendimi ». Pas shortimit të çështjes u caktuan si anëtarë të trupit gjykues gjyqtari Luan Lusha dhe Diamela Goxha. Anëtari Luan Lusha për shkak të dhënies së vendimit, i cili kërkohej të rishikohej dhe duke qënë se kërkuari kishte pretendime konsistente në lidhje me vendimin e marrë prej tij, duke e cilësuar si të padrejtë, i paraqiti Kryetares së gjykatës dorëheqjen, e cila me Vendimin nr. 10, datë 08.02.2019 i'u pranua. Pas rishortimit, si anëtare e trupit gjykues u caktua gjyqtarja Entela Shedula, e cila duke qënë se kishte qënë kryetare e trupit gjykues që kishte dhënë Vendimin nr. 87, datë 05.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, i cili dispononte mbi po të njëjtën kërkesë, paraqiti kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështje. Me Vendimin nr. 36, datë 20.02.2019 Kryetari i Gjykatës së Apelit Durrës, vendosi pranimin e kërkesës për heqjen dorë të gjyqtares Entela Shedula. Me shkresën nr. 339 prot., datë 25.02.2019 i'u kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor delegimi i një gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues. Me Vendimin nr. 47, datë 20.03.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendoi delegimin e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës Znj. Eda Kaja në përbërje të trupit gjykues për gjykimin e kësaj çështje. Pra, kohezgjatja tej afatit ka ardhur për arsye procedurale.

Vlerësoj se faktet e mësipërme duhet të merren në konsideratë, pasi lidhen me arsye ligjore dhe objektive, të cilat kanë ndikuar në mos respektimin e afatit ligjor dhe janë lehtësisht të vërtetueshme, duke verifikuar secilën prej dosjeve. ”.

Në analizë të këtyre shpjegimeve, rezulton se gjyqtari ka dhënë shpjegime të arsyeshme dhe të pranueshme, për 35 prej tyre. Duke zbritur nga numri total 125, këto 35 çështje, numri i tyre shkon në 90 ose 18.5% .

Gjithashtu, duhet marrë parasysh edhe;

- a) përjashtimin nga kjo periudhë, kohën që mund të ketë marrë lëvizja e dosjes nga momenti i regjistrimit deri të shortimi dhe dorëzimi të gjyqtarit,
- b) kohën që i është dashur gjyqtarit për shtyrje të gjykimit për shkaqe të pavarura prej tij, si është njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve,
- c) diferencën e vogël në kohë të kalimit të standardit minimal kohor, në lidhje me këtë tregues, gjyqtari pikëzohet në nivelin “Mbi mesatar”, duke u pikëzuar me 4 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 4 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, për shumicën e kategorive të

çështjeve.

Sipas raportit analitik, rezulton se;

Në total, gjyqtari subjekt vlerësimi, ka gjykuar në cilësinë e relatorit 486 çështje (*standard minimal kohor*), nga të cilat:

- (i) Në lidhje me 44 (*dyzet e katër*) çështje civile të kategorisë "*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*", koha mesatare rezulton të jetë 155.3 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261 të ish KLD-së.
- (ii) Në lidhje me 101 (*njëqind e një*) çështje civile të kategorisë "*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*", koha mesatare rezulton të jetë 54.2 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261 të ish KLD-së.
- (iii) Në lidhje me 49 (*dyzet e nëntë*) çështje të kategorisë "*familjare me palë kundërshtare*", koha mesatare rezulton të jetë 150.7 ditë pra më e gjatë se afatit 4 (katër) muaj i parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (iv) Në lidhje me 11 (*njëmbëdhjetë*) çështje të kategorisë "*familjare pa palë kundërshtare*" koha mesatare rezulton të jetë 49.3 ditë pra më e shkurtër se afati standard minimal kohor prej 2 (dy) muaj i parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (v) Në lidhje me 5 (*pesë*) çështje të kategorisë "*marrëdhënie pune*", koha mesatare rezulton 172.2 ditë pra me e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (vi) Në lidhje me 25 (*njëzet e pesë*) çështje të kategorisë "*penale krime*", koha mesatare rezulton 62.8 ditë pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 (nëntë) apo 12 (dymbëdhjetë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (vii) Në lidhje me 3 (*tri*) çështje të kategorisë "*kundravajtje penale*" koha mesatare rezulton 82.3 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 4 (katër) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (viii) Në lidhje me 90 (*nëntëdhjetë*) çështje të kategorisë "*seanca paraprake me objekt pushim procedimi*", koha mesatare rezulton 38.3 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 2 (dy) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (ix) Në lidhje me 158 (*njëqind e pesëdhjetë e tetë*) çështje të kategorisë "*kërkesa penale në fazën e ekzekutimit*"¹, koha mesatare rezulton 42.4 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 2 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

Pra, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategorive të çështjeve.

¹Në total 158 çështje pasi 139 çështje janë tek tabela 12 dhe 19 çështje të kësaj kategorie janë vendosur gabim tek tabela e seancave paraprake.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari në lidhje me këtë tregues shpjegon se; “Për këtë rubrikë përsëri vlerësoj se kam aftësi shumë të larta, pasi jam përpjekur maksimalisht të respektoj afatet e gjyqimit dhe kushtoj çështjeve kohën e duhur, pavarësisht se kompleksiteti tyre, ngarkesa e gjykatës, modalitetet, apo problemet me njoftimet, sjellja e palëve, apo arsye objektive të ndryshme mund të kenë çuar në zgjatjen e afatit.”

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, është më e gjatë se standardi minimal kohor vetëm për një kategori konkretisht, për kategorinë “Familjare me palë kundërshtarë”. Ndërkohë, në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari, për treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore”, ka dhënë shpjegime të arsyeshme dhe të pranueshme për 12 çështje të kësaj kategorie. Nëse nga 49 çështje të kësaj kategorie, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, do të zbriteshin 12 çështjet për të cilat gjyqtari ka dhënë shpjegime, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje edhe për këtë kategori do të ishte 111 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 4 muaj, i parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.

Në analizë të këtyre shpjegimeve, në lidhje me këtë tregues, gjyqtari vlerësohet në nivelin maksimal, duke u pikëzuar me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore nga gjyqtari është 113,7 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor nga ana e gjyqtarit, është më e shkurtër se afati procedural, për shumicën e kategorive të çështjeve.

Sipas raportit analitik, rezulton se; Referuar të dhënave statistikore, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është si më poshtë vijon:

- Për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtarë”, koha mesatare e arsytimit është 15.1 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.

- Për çështje të kategorisë "*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*", koha mesatare e arsyetimit është 10.4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- Për çështje të kategorisë "*familjare me palë kundërshtare*", koha mesatare e arsyetimit është 16.7 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- Për çështje të kategorisë "*familjare pa palë kundërshtare*", koha mesatare e arsyetimit është 15.9 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- Për çështje të kategorisë "*marrëdhënie pune*", koha mesatare e arsyetimit është 17.4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- Për çështje të kategorisë "*kërkesa penale të hetimit paraprak*", për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi si dhe zëvendësim mase sigurimi, koha mesatare e arsyetimit është 7.75 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 249 dhe 260 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë "*kërkesa penale të hetimit paraprak*", për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt verifikim kushtesh dhe kriteresh të caktimit të masës së sigurimit, koha mesatare e arsyetimit është 4 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248/2 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë "*kërkesa penale të hetimit paraprak*", për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt vleftësim, lejim apo zgjatje e përgjimit, koha mesatare e arsyetimit është 0 ditë, pra menjëherë me shpalljen e vendimit sikundër është parashikuar nga neni 222 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë "*kërkesa penale të hetimit paraprak*", për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt kundërshtim vendimi mosfillimi, koha mesatare e arsyetimit 10.1 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë "*kërkesa penale të hetimit paraprak*", për të cilat ligji procedural edhe pse nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt përjashtim gjyqtari, koha mesatare e arsyetimit është 3.8 ditë, pra më e gjatë se afati 48 orë i parashikuar nga neni 22/3 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë "*penale krime*", koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 23.4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural prej 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë "*penale kundravajtje*", koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 22.3 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural prej 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë "*seancë paraprake – dërgim në gjyq*", koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 9.8 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural prej 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh pg 3 i K. Pr. Penale.
- Për çështje të kategorisë "*seancë paraprake – pushim procedimi*" koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 16.3 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural prej 30

ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K. Pr. Penale.

- Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale në fazën e ekzekutimit*” për të cilën nuk parashikohet ndonjë afat i posaçëm për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 12.4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural prej 30 ditësh i parashikuar nga neni 430/1 i K. Pr. Penale”.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari në lidhje me këtë tregues shpjegon se: “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor” në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; e lartë) duke theksuar se: “Vlerësimi im do të ishte shumë i lartë për shumicën e kategorive të çështjeve. Në këtë rubrikë doja të sqaroja se pjesa e konsiderueshme e vendimeve që janë dorëzuar jashtë afatit i përkasin muajit Mars, Qershor dhe Korrik 2019. Kjo ka ndodhur për arsye se 10 ditëshin e fundit të muajit Mars kam konsumuar pjesën e lejes së mbetur pa kryer nga viti 2018; nga data 3-13 Qershor kam konsumuar një pjesë të lejes së vitit 2019 dhe për shkak të lejes së muajit Gusht. Vlerësoj se nuk duhet llogaritur si kohë e arsyetimit periudha që kam qenë me lejë dhe rrjedhimisht performanca të jetë më e lartë. Bashkëlidhur po paraqes edhe urdhërat përkatës të Kryetarit për miratimin e lejes për secilën periudhë. Një pjesë e vendimeve të cilat janë dorëzuar me 1-3 ditë vonesë, i kam arsyetuar në kohë, por për shkak të ngarkesës, nga ana e sekretares gjyqësore është shënuar data faktike e dorëzimit në k/sekretari, pa shënuar datën e saktë të vendosjes në dispozicion të vendimit prej meje, pasi nuk është lejuar nga K/sekretarja. Nga regjistri rezulton qartë që për të dyja rubrikat ka nënshkruar sekretarja gjyqësore. Vendimet për të cilat është tejkalluar afati i arsyetimit/dorëzimit dhe kjo lidhet me arsyen e sipër përmendur janë:

A. Në lidhje me çështjet civile të përgjithshme me palë kundërshtare:

- Çështja me nr. rendor 8, dt. vendimi 24.07.2019 dhe dt. dorëzimi 09.09.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 9, dt. vendimi 30.05.2019 dhe dt. dorëzimi 03.07.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 30, dt. vendimi 29.05.2019 dhe dt. dorëzimi 28.06.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 44, dt. vendimi 29.07.2019 dhe dt. dorëzimi 09.09.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 46, dt. vendimi 28.05.2019 dhe dt. dorëzimi 28.06.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 50, dt. vendimi 31.05.2019 dhe dt. dorëzimi 28.06.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 59, dt. vendimi 16.07.2019 dhe dt. dorëzimi 09.09.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 60, dt. vendimi 30.05.2019 dhe dt. dorëzimi 08.07.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 69, dt. vendimi 12.03.2019 dhe dt. dorëzimi 08.04.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 82, dt. vendimi 29.05.2019 dhe dt. dorëzimi 28.06.2019 .

B. Në lidhje me çështjet gjyqësore civile pa palë kundërshtare:

- Çështjet me nr. rendor 48, 49, 50, 51, 52, dt. vendimi 29.07.2019 dhe dt. dorëzimi 22.08.2019.

C. Në lidhje me çështjet gjyqësore familjare me palë kundërshtare:

- Çështja me nr. rendor 1, dt. vendimi 30.05.2019 dhe dt. dorëzimi 03.07.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 6, dt. vendimi 11.03.2019 dhe dt. dorëzimi 11.04.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 7, dt. vendimi 22.07.2019 dhe dt. dorëzimi 22.08.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 18, dt. vendimi 30.07.2019 dhe dt. dorëzimi 30.08.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 41, dt. vendimi 12.03.2019 dhe dt. dorëzimi 08.04.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 44, dt. vendimi 05.03.2019 dhe dt. dorëzimi 06.04.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 45, dt. vendimi 19.03.2019 dhe dt. dorëzimi 12.04.2019 ;
- Çështja me nr. rendor 54, dt. vendimi 21.05.2019 dhe dt. dorëzimi 21.06.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 55, dt. vendimi 11.03.2019 dhe dt. dorëzimi 03.04.2019 .

D. Në lidhje me çështjet gjyqësore penale krime:

-Çështja me nr. rendor 2, dt. vendimi 03.06.2019 dhe dt. dorëzimi 08.07.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 3, dt. vendimi 24.07.2019 dhe dt. dorëzimi 22.08.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 6, dt. vendimi 16.05.2019 dhe dt. dorëzimi 21.06.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 7, dt. vendimi 29.07.2019 dhe dt. dorëzimi 09.09.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 13, dt. vendimi 15.07.2019 dhe dt. dorëzimi 22.08.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 16, dt. vendimi 22.07.2019 dhe dt. dorëzimi 22.08.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 17, dt. vendimi 29.07.2019 dhe dt. dorëzimi 09.09.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 22, dt. vendimi 16.05.2019 dhe dt. dorëzimi 21.06.2019 ;

E. Në lidhje me çështjet gjyqësore penale kundërvajtje:

-Çështja me nr. rendor 1, dt. vendimi 25.02.2019 dhe dt. dorëzimi 02.04.2019 .

F. Në lidhje me çështjet gjyqësore penale seancë paraprake:

-Çështja me nr. rendor 1, dt. vendimi 22.05.2019 dhe dt. dorëzimi 28.06.2019 (themeli);

-Çështja me nr. rendor 36, dt. vendimi 18.03.2019 dhe dt. dorëzimi 02.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 79, dt. vendimi 06.03.2019 dhe dt. dorëzimi 03.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 83, dt. vendimi 05.03.2019 dhe dt. dorëzimi 02.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 84, dt. vendimi 06.03.2019 dhe dt. dorëzimi 03.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 85, dt. vendimi 06.03.2019 dhe dt. dorëzimi 02.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 86, dt. vendimi 15.03.2019 dhe dt. dorëzimi 02.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 94, dt. vendimi 06.03.2019 dhe dt. dorëzimi 02.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 98, dt. vendimi 15.03.2019 dhe dt. dorëzimi 10.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 100, dt. vendimi 28.02.2019 dhe dt. dorëzimi 02.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 101, dt. vendimi 28.02.2019 dhe dt. dorëzimi 02.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 103, dt. vendimi 15.03.2019 dhe dt. dorëzimi 09.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 108, dt. vendimi 05.03.2019 dhe dt. dorëzimi 07.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 109, dt. vendimi 05.03.2019 dhe dt. dorëzimi 02.04.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 114, dt. vendimi 29.05.2019 dhe dt. dorëzimi 08.07.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 127, dt. vendimi 23.05.2019 dhe dt. dorëzimi 03.07.2019 ;

-Çështja me nr. rendor 136, dt. vendimi 29.05.2019 dhe dt. dorëzimi 03.07.2019 .

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit, është më e gjatë se afatet procedurale vetëm për kategorinë “kërkesa penale të hetimit paraprak” konkretisht;

- Për çështjet me objekt vlefësim arresti dhe caktim mase sigurimi si dhe zëvendësim mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është 7.75 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 249 dhe 260 i K. Pr. Penale.
- Për çështjet me objekt verifikim kushtesh dhe kriteresh të caktimit të masës së sigurimit, koha mesatare e arsytimit është 4 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248/2 i K. Pr. Penale.
- Për çështjet me objekt përjashtim gjyqtari, koha mesatare e arsytimit është 3.8 ditë, pra më e gjatë se afati 48 orë i parashikuar nga neni 22/3 i K. Pr. Penale.

Evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore tejkalohe vetëm për një nga kategoritë e çështjeve, konkretisht për kategorinë “kërkesa penale të hetimit paraprak”.

duke u tejkualuar me 2.75 ditë, 2 ditë apo 1.8 ditë, tejkalime këto të papërfillshme, referuar këtu edhe ngarkesës së punës për periudhën e vlerësimit. Për këtë tregues, duke zbatuar koeficientin, jo më shumë se 20%, gjyqtari pikëzohet në nivelin maksimal, pra në nivelin “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse) është 2.6 dhe nga ana e gjyqtarit janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar; a) analizës së çështjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nga të cilat evidentohet se; “Gjyqtari ka kryer veprimet procedurale të nevojshme për njoftimin në mënyrë efektive të të gjitha palëve ndërgjyqëse. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara në dosje si: vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, vendimet për caktimin e seancave paraprake, etj. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qënë i rregullt dhe gjykata rezulton që të jetë shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të palëve ndërgjyqëse në përputhje edhe me llojin e gjykimit (*seancë paraprake apo gjykim themeli*). Në përgjithësi konstatohet se seancat kanë filluar pa vonesa të konsiderueshme. Konstatohet gjithashtu se seancat gjyqësore janë të regjistruara me sistemin audio, por, ndërkohë është mbajtur edhe procesverbal në mënyrë të përmbledhur dhe b) burimeve të tjera të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarit janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarit renditja e akteve të dosjes gjyqësore është në atë mënyrë që e bën dosjen lehtësisht të shfrytëzueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet që dokumentacioni në dosje, është në përputhje me veprimet procedurale të kryera, nuk ka mungesa, dhe se është i duhuri.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
99	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenim të etikës apo përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksionit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje, apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit, gjatë ushtrimit të funksionit.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe **nuk** rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjtetin e tij.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton që gjyqtari, të ketë përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit, si dhe në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuarra të palëve për përjashtimin e gjyqtarit

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit si dhe gjyqtari nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për heqje dorë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent, me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve, apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, gjyqtari në këtë tregues, vlerësohet në nivelin “Shumë i lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ai ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën

gjqësore, prezumohet se ai ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari gjatë vitit 2019, ka marrë pjesë në programet e formimit vazhdues me cilësinë e pjesëmarrësit, konkretisht, gjyqtari ka qënë pjesëmarrës në 5 trajnime, përgjatë 7 ditëve. Kjo kohëzgjatje është brenda kufijve 5 deri në 40 ditë, në periudhën njëvjeçare të vlerësimit.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se për periudhën e vlerësimit, për gjyqtarin nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues. Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtari, vlerësohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari është angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale që kanë pasur si qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë, apo aktivitete të tjera. Konkretisht, referuar Vërtetimit datë 11.06.2021 të Fakultetit të Drejtësisë rezulton se z. _____ është angazhuar në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës si pedagog efektiv në vitin akademik 2010-2011 dhe si pedagog me kohë të pjesshme për vitet akademike 2012-2013, 2013-2014, 2014-2015, 2016-2017, 2017-2018 dhe **2018 – 2019**.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se, për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin Genti Dokollari, duke qenë se rezultojnë të dhëna, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk evidentohet asnjë publikim ligjor i realizuar nga gjyqtari gjatë vitit 2019.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	97	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	99	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	389	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, Këshilli rekomandon që gjyqtari Genti Dokollari, të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT, PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 01.01.2019-31.12.2019 I GJYQTARIT

1. AFTËSITË PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				97	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë		
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore te dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore te dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë	

					Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarët 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarëve 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren	12	Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarët 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarëve 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarët 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarëve 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				99	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	15	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi mesatare	4	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë

					<p>Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë</p> <p>Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë</p> <p>Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë</p>
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<p>1. Të dhënat statistikore</p> <p>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</p> <p>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	Shumë e lartë	10	<p>Tej standardit :</p> <p>Nën 81 %- 2 pikë</p> <p>Mbi 81-87 % - 4 pikë</p> <p>Mbi 87- 93 % - 6 pikë</p> <p>Mbi 93-99 % - 8 pikë</p> <p>+99% - 10 pikë</p>
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<p>1. Të dhënat statistikore</p> <p>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</p> <p>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	Shumë e lartë	15	<p>Koha mesatare:</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6</p>

					<p>pikë</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë</p> <p>Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë</p> <p>Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë</p>
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 	Shumë e lartë	15	<p>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</p> <p>Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë</p> <p>Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë</p> <p>1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë</p>

	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtrit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë

					Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Nuk ka asnjë kërkesë të pranuar të palëve për përjashtim gjyqtari	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				93	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i	I Lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit:

	personale	kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short			I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	Mbi 5 ditë (për periudhën 1 vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4



	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimi ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			389		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shkëlqyeshëm		

RELATOR
BRUNILDA KADI